


**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË SUHAREKË**, Gjyqtarja Lirije Kafexholli me sek.juridike Belkize Gashi në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Bali Ali Muharremaj nga fsh. Gjinoc-Suharekë, për shkak të vepres kundërvajtëse nga neni 16 paragrafi I.I të Ligjit për deklarimin, prejadhjën dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të lartë publik, e në bazë të nenit 73,195 dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datë, 19.04.2011 merrë këtë:

### A K T V E N D I M

**I PANDEHURI:** Bali Ali Muharremaj i lindur me 22.02.1964 në fsh. Gjinoc tani me vendbanim në Prizren Rr." Edit Durhan" nr. 167, ku dhe tani jeton, i martuar i ati 4 femive, ka të kryer fakultetin, gjërë me tani kinse jo i denuar.

### Ë S H T Ë P Ë R G J E G J E S

Sepse si Zyrtar i lartë publik - Nënkyetar i Kuvendit Komunal Suharekë nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë së tij për vitin 2009 deri me 31.03.2010 në Agjencionin Kundër Korrupsionit në Prishtinë. Me këtë veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 16 paragrafi I.I të Ligjit për deklarimin, prejadhjën dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të lartë publik e të njëjtit.



### G J O B I T E T

Me gjorbë në të holla në shumë prej 300 (Treqindë) EURO të cilin ka për ta paguar brenda 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij Aktvendimi në favor të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me nr.gjirollg.1000-4300-7000-0518, pagesa bëhet nëpërmes të kësaj gjykate.

Nese denimin e caktuar nuk e paguan në afatin e caktuar i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 20 ditësh duke i u llogaritur nga 15 EURO. qdo ditë burgimi.

Shpenzimet e procedurës kundërvajtëse shuma paushalle prej 5 EURO, i paguan i pandehuri në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merrë formën e prerë në favor të Gjykatës Komunale për kundërvajtje në Suharekë.

Me nga një ekzemplar të këtij aktvendimi të njoftohenë palet.

### A R S Y E T I M

Me kërkesen e Agjencionit Kundër Korrupsionit në Prishtinë me nr. 01/2257/10 të dt. 08.06.2010 është ngritur procedura kundërvajtëse, kundër të pandehurit me motivacion se ka kryer kundërvajtje.

Për vertetimin e gjendjës faktike gjykata ftoi të pandehurin Bali Muharremaj i cili në mbrojtje të vet deklaroi se është e vertet se Agjencionit kundër korrupsionit nuk ia ka deklaruar pasurinë për vitin 2009 mbrenda afatit ligjor deri me 31.03.2010 për shkak të disa pengesave që ka patur, por deklarimin e pasurisë e ka bërë me vones në fillim të muajit nëntor të vitit 2010, njeherit ka deklaruar se për viteve tjera e ka deklaruar pasurinë në afat të rregullt ligjor.


Gjykata pas vlersimit të të gjitha provave në shqyrtimin kryesor: deklaratës se të pandehurit, dhe pas vlersimit të të gjitha shkresave të cilat gjenden në lende, konstatoj se i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 16 paragrafi I.I të Ligjit për deklarimin, prejadhjën dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të lartë publik andaj Gjykata të pandehurin e shpalli përgjegjës dhe ia shqiptoj denimin në të holla në shumë prej 300 EURO.

Gjykata me rastin e shqiptimit të denimit pati parasysh të gjitha rrethanat rënduse dhe lehtësuse të cilat ndikojnë në marrjen e Aktvendimit dhe se mendon edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i denimit dhe do të ndikoj pozitivisht tek i pandehuri që në të ardhmën të mos përsëris kundërvajtje të natyres së tillë,

Me sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

### GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË SUHAREKË

Sek.juridike  
Belkize Gashi



**UDHEZIME JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi kanë të drejtë ankese i pandehuri dhe parashtrusi i kërkeses, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh, pas marrjes së këtij Aktvendimi nëpërmes kësaj Gjykate.